



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 933 Prot.

Tiranë, më 19.04.2021

VENDIM QARKULLUES

Nr. 28, datë 16.04.2021

PËR

**“TARIFAT E KONKURRIMIT, TË APLIKIMIT DHE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Qarkullues nr. 108, datë 29.12.2020 “Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit:

VENDOSI:

1. Të miratojë, të pa ndryshuar, tarifën e konkurrimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në masën 5.000 (pesë mijë) lekë.
2. Të miratojë, të pa ndryshuar, tarifën e aplikimit për transferim të studimeve në programet e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në masën 5.000 (pesë mijë) lekë .
3. Të miratojë, të pa ndryshuar, tarifën vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në masën 115.000 ( njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
4. Studentët që shpallen fitues, paguajnë/arkëtojnë menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera paguhen sipas afateve dhe masës që përcaktohet nga fakultetet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e tij.

KRYETARI  
FLORIAN TOTI

